

VENDIM
Nr. 30, datë 2.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.10.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (GJ) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Banka e Shqipërisë

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve

Shoqata Shqiptare e Bankave

OBJEKTI: Shfuqizimi i shprehjes “*gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*”, në shkronjën “d”, të paragrafit të pestë, të nenit 511, të Kodit të Procedurës Civile.

BAZA LIGJORE: Neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*gjykata referuese*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, shpjegimet e Bankës së Shqipërisë dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, që nuk kanë mbajtur qëndrim mbi kërkesën, dhe prapësimet e Shoqatës Shqiptare të Bankave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Banka Kombëtare Tregtare (BKT), në datën 20.3.2018 ka lidhur kontratën e kredisë konsumatore me kredimarrës një individ në vlerën 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me afat shlyerjeje 84 (tetëdhjetë e katër) muaj. Për shkak të vonesave në përmbushjen e detyrimeve kontraktore, BKT-ja ka njoftuar kredimarrësin për nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm. Pasi nuk ka marrë përgjigje prej tij, në datën 7.6.2021 ajo i është drejtuar *gjykatës referuese* për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit bazuar në nenet 510, shkronja “d” dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), si dhe për llogaritjen e kamatave ligjore të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë

bankare” sipas ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” (*ligji nr. 48/2014*). Në kërkesën drejtuar gjykatës referuese, banka ka parashtruar se deri në datën 26.5.2021 kredimarrësi ka paguar shumën 31,770.59 lekë dhe ka detyrimin 536,234.14 lekë, nga të cilat 418,229.41 lekë principal; 77,525.75 lekë interes i papaguar; 14,962.93 lekë penalitete mbi interesin; 24,116.05 lekë penalitete mbi principalin; 1,400.00 lekë shpenzime të tjera.

2. Ligji nr. 48/2014 parashikon rregullat për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara në rastet e furnizimit me mallra ose shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike. Sipas nenit 2 të tij, ligji zbatohet për të gjitha pagesat e kryera si kundërpaguesë për veprimet juridike tregtare, ndërsa nuk u nënshtrohen rregullave të tij detyrimet ose pagesat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët.

3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, gjykata referuese ka çmuar se shkronja “d” e paragrafit të pestë të nenit 511 të KPC-së bie në kundërshtim me Kushtetutën, Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit (MSA), direktivën 2011/7/BE, datë 16 shkurt 2011, “Për luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare” (*direktiva 2011/7/BE*), Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollin nr. 1 të saj. Për rrjedhojë, në datën 23.2.2022 gjykata referuese ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për kontrollin e kushtetutshmërisë së shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të KPC-së, e cila parashikon: “Urdhri i ekzekutimit përmban: [...] d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.”. Kjo dispozitë është shtuar me ndryshimet që ka pësuar neni 511 i KPC-së me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016.

4. Kolegji i Gjykatës, në datën 23.5.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare në bazë të dokumenteve.

5. Në datën 22.6.2022 në Gjykatë është regjistruar kërkesa e Shoqatës Shqiptare të Bankave për të marrë pjesë në gjykim në cilësinë e subjektit të interesuar. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në datën 19.9.2022 ka vendosur pranimin e kërkesës me arsyetimin se pjesëmarrja e kësaj shoqate është në interes të gjykimit kushtetues, për shkak të veprimtarisë që ajo zhvillon në mbështetje të sektorit bankar në Shqipëri.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Gjykata referuese** ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se shkronja “d” e paragrafit të pestë të nenit 511 të KPC-së cenon:

6.1 *Të drejtat e konsumatorit*, pasi kamata ligjore e titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” vendos barrë të paarsyeshme ligjore dhe ekonomike, që bie në kundërshtim me direktivën 2011/7/BE dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, sipas të cilave kamatat ligjore të parashikuara në direktivë nuk zbatohen për konsumatorët, por vetëm për marrëdhëniet juridike tregtare midis ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të përbashkët brenda Bashkimit Evropian (BE).

6.2 Detyrimin për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, si një angazhim i marrë nga shteti shqiptar në zbatim të neneve 6 dhe 70 të MSA-së. Për rrjedhojë, ajo ka cenuar *parimin e hierarkisë së normave*, në kuptim të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, pasi bie ndesh me nenin 76 të MSA-së dhe direktivën 2011/7/BE.

6.3 *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi normat e larta të interesit e ngarkojnë individin me barrë të rëndë pasurore, që nuk respekton *parimin e proporcionalitetit*, gjë që bie në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës dhe është në tejkalim të kufizimeve të KEDNJ-së. Dispozita e kundërshtuar e

ngarkon individin me kamata ligjore të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” sipas ligjit nr. 48/2014 për pagesa të vonuara të borxheve që janë marrë për konsum dhe jo për aktivitet tregtar, ndonëse vetë ky ligj parashikon se nuk zbatohet për konsumatorët.

6.4 *Të drejtën e procesit të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi nuk i siguron individit mbrojtjen e duhur ndaj ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve. Ndërhyrja në të drejtën e pronës nuk shoqërohet me garancitë procedurale të nevojshme për individin, të përcaktuara nga nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Legjislacioni i brendshëm nuk ka mjet efektiv për mbrojtjen e debitorit, pasi procesi gjyqësor i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit zhvillohet në dhomë këshillimi pa praninë e palës, në mungesë të mbrojtjes dhe pa kontradiktoritet mbi ligjin ose provat.

6.5 *Lirinë kontraktore*, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi dispozita ligjore nuk e mbron konsumatorin debitor, i cili është individ në pozicion të dobët, në kontratat standarde, duke i sjellë humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të tij.

7. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

7.1 Gjykata *nuk ka juridiksion* për kontrollin e dispozitës ligjore të kundërshtuar në raport me direktivën 2011/7/BE, pasi Republika e Shqipërisë nuk është ende shtet anëtar i BE-së. Edhe pretendimi për përplasje të dispozitës ligjore të kundërshtuar me ligjin nr. 48/2014, referuar jurisprudencës kushtetuese, nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues. Po kështu, çështja është *res judicata*, pasi Gjykata me vendimin nr. 39, datë 16.10.2007 ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e togfjalëshit “si dhe aktet e dhënies së kredisë bankare” të nenit 510, shkronja “d”, të KPC-së.

7.2 Gjykata referuese *nuk legjitimohet*, pasi e ka pasur mundësinë për ta zgjidhur çështjen duke zbatuar drejtpërdrejt MSA-në. Po kështu, ajo po zhvillon një proces formal gjyqësor, ku mungon debati gjyqësor, për pasojë nuk mund të iniciojë një gjykim incidental.

7.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës private*, të sanksionuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit të KEDNJ-së, nuk qëndron. Kuvendi me parashikimet e dispozitës ligjore të kundërshtuar ka synuar stabilitetin e sistemit bankar dhe ndërgjegjësimin e konsumatorit në respektimin e kushteve të përcaktuara në kontratë. Është i gabuar pretendimi se përllogaritja e kamatës ligjore të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” duhet të kryhet sipas nenit 450 të KC-së, pasi ky nen është i përgjithshëm dhe nuk përcakton se si llogariten kamatat ligjore për detyrimet monetare.

7.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të lirisë ekonomike*, i sanksionuar nga neni 11 i Kushtetutës, është i pabazuar, pasi gjykata referuese ka parashtruar argumente për çështje ligjore dhe për natyrën e kontratës së kredisë bankare në raport me të drejtën e pronës. Parashikimi që ka bërë ligjvënësi është i përligjur dhe i justifikuar në këndvështrimin e konceptit kushtetues “interes publik”.

7.5 Pretendimi për cenimin e *procesit të rregullt ligjor* në kuptim substancial, i sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13, pika 1, të KEDNJ-së, është përtej objektit të kërkesës, pasi ka të bëjë me natyrën e procesit të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, të parashikuar në nenin 511, paragrafi i tretë, të KPC-së.

8. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, përmbledhtazi, ka prapësuar se:

8.1 Gjykata *nuk ka juridiksion* për papajtueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar me direktivën 2011/7/BE, pasi Republika e Shqipërisë nuk është shtet anëtar i BE-së. Pretendimi për mungesën e harmonizimit ndërmjet dispozitës së kundërshtuar dhe ligjit nr. 48/2014 nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues. Dispozita e kundërshtuar është zgjidhje legjislative e Kuvendit dhe synon reduktimin e kredisë me probleme. Gjykata nuk mund të marrë rolin e ligjvënësit, ndaj çështja qëndron jashtë juridiksionit kushtetues. Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt përbën *res judicata*, pasi është vlerësuar nga Gjykata në vendimin nr. 39, datë 16.10.2007.

8.2 Gjykata referuese *nuk legjitimohet*, pasi ajo i ka pasur mundësitë për zgjidhjen e gjykimit duke zbatuar drejtpërdrejt marrëveshjen ndërkombëtare, në përputhje me nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës. Duke qenë se procesi gjyqësor i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit ka natyrë formale dhe jo përfundimtare, gjykata referuese nuk mund të iniciojë një gjykim kushtetues abstrakt për kontrollin e një norme ligjore që nuk zgjidh themelin e çështjes. Vendimmarrja e Gjykatës duhet

të shtrihet vetëm për shprehjen “*në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*”. Gjykata referuese ka pezulluar gjykimin pa marrë mendimin e palës kërkuese, në kushtet kur pezullimi vonon përtej afatit të arsyeshëm ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

8.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës private* është i pabazuar, pasi dispozita e kundërshtuar mbron interesin publik që lidhet me stabilitetin e sistemit bankar dhe ndërgjegjësimin e konsumatorit për rëndësinë e shlyerjes në kohë të shumave të kredisë. Përlllogaritja e kamatave ligjore të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” nuk bëhet sipas nenit 450 të KC-së, pasi kjo dispozitë është me karakter të përgjithshëm. Ligjvënësi ka parashikuar se kamata përcaktohet nga gjykata në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

8.4 Pretendimi për cenimin e *lirisë ekonomike* nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi gjykata referuese nuk ka parashtruar shkaqe reale kushtetuese që sjellin antikushtetutshmërinë e normës së kundërshtuar me parimin përkatës. Në thelb, argumentet e gjykatës referuese ngrihen për çështje ligjore për natyrën e kontratës së kredisë bankare në raport me të drejtën e pronës.

9. **Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë**, nuk ka mbajtur qëndrim mbi objektin e kërkesës, duke parashtruar se me vendimin nr. 47, datë 1.9.2021, “Për disa ndryshime në rregulloren për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore”, Këshilli Mbikëqyrës ka caktuar tavan për kamatëvonesat.

10. **Subjekti i interesuar, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve**, nuk ka mbajtur qëndrim për objektin e kërkesës, duke u shprehur se çështja lidhet me një dispozitë ligjore që nuk është pjesë e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, për rrjedhojë nuk është pjesë e përgjegjësiave të tij.

11. **Subjekti i interesuar, Shoqata Shqiptare e Bankave**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

11.1 Gjykata *nuk ka juridiksion*, pasi e ka vlerësuar çështjen më parë, duke argumentuar se e drejta e debitorit për të kundërshtuar dhe për t’u dëgjuar për kërkimet e tij lidhur me vlerën e detyrimit nëpërmjet një gjykimi themeli me palë kundërshtare garantohet nga neni 609 i KC-së.

11.2 Gjykata referuese *nuk legjitimohet*, pasi nuk ka identifikuar ligjin e zbatueshëm, nuk ka parashtruar arsye serioze antikushtetutshmërie, nuk ka argumentuar përse gjykimi prej saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues, nuk ka hetuar në mënyrë shteruese mundësinë e zgjidhjes së çështjes nëpërmjet zbatimit të dispozitave të tjera ligjore, si dhe nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar këtë dispozitë në përputhje me Kushtetutën. Qëndrimi i gjykatës referuese është në kundërshtim me praktikën e ndjekur nga vetë ajo në çështje të ngjashme kur është kërkuar lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nga subjektet bankare për kredi konsumatore ose për kredi të tjera ndaj individëve.

11.3 Pretendimi se dispozita e kundërshtuar bie ndesh me *MSA-në dhe direktivat e BE-së* është i pabazuar, pasi direktiva 2011/7/BE nuk rregullon procedurat e nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit. Në bazë të parimit të hierarkisë së normave, ligji nr. 48/2014, që ka transpozuar direktivën, renditet më poshtë se KPC-ja.

11.4 Pretendimi se dispozita e kundërshtuar cenon *lirinë ekonomike* nuk qëndron, pasi liria kontraktore, në kuptim të nenit 686 të KC-së, lidhet me cilësinë e kredisë bankare si titull ekzekutiv dhe jo me nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit. Në procedurën e nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit nuk përcaktohen kushte kontraktore të tjera përveç atyre që janë pranuar nga palët në kontratën e kredisë bankare. Çështja e kamatëvonesave nuk përcaktohet nga dispozita e kundërshtuar, kjo e fundit referon në kuadrin ligjor që renditet më poshtë se kodet. Shpallja antikushtetuese e shkronjës “d” të nenit 511 të KPC-së cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike të subjekteve bankare, të cilat i realizojnë interesat e tyre ekonomike përmes kredidhënies bankare.

11.5 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi gjykata ka paragjykuar barrën e detyrimit që i ngarkohet konsumatorit pa kryer një vlerësim ekonomik të detyrimit në

rastin konkret. Ajo ka injoruar faktin që ligji nr. 48/2014 shprehimisht e ka përjashtuar individin konsumator nga zbatimi i tij.

11.6 *Parimi i proporcionalitetit*, i parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës, nuk cenohet, pasi gjykata referuese ka keqinterpretuar rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Kur lëshohet urdhri i ekzekutimit, kontrata e kredisë konsiderohet e zgjidhur dhe banka kërkon kthimin e të gjithë kredisë së papaguar, duke përfshirë këstet e pamaturuara, sipas planit të pagesës, interesat dhe penalitetet e akumuluar. Siç ka pranuar Gjkata në vendimin nr. 39, datë 16.10.2007, parashikimi i nenit 510, shkronja “d”, të KPC-së në thelbin e vet nuk cenon të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

12. Gjkata konstaton se subjektet e interesuara kanë kundërshtuar juridiksionin e saj për të vendosur për çështjen në dy aspekte, të cilat lidhen me pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me direktivën 2011/7/BE dhe me parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*).

13. Në lidhje me juridiksionin kushtetues në raport me direktivën 2011/7/BE, gjykata referuese ka sjellë në vëmendje se Gjkata, në jurisprudencën e saj: “*e ka shpallur veten kompetente për t’u shprehur lidhur me pajtueshmërinë e një ligji të brendshëm me një instrument ligjor të BE-së*” kur ka pranuar për shqyrtim dhe ka gjykuar në themel kërkesa për shpalljen e antikushtetutshmërisë së ligjeve që binin në kundërshtim me një direktivë të BE-së.

14. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se kontrolli kushtetues nuk mund të ushtrohet për direktivën e BE-së për sa kohë që Republika e Shqipërisë nuk është shtet anëtar i kësaj organizate. Kontrolli kushtetues mund të ushtrohet vetëm për përputhshmërinë e ligjeve/akteve normative me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj. Po kështu, edhe pretendimi për mospërbushjen e detyrimit të shtetit shqiptar për harmonizimin e legjislacionit me atë të BE-së qëndron jashtë juridiksionit kushtetues. Për më tepër, që vetë ligjvënësi shqiptar ka zgjedhur përafrimin pjesërisht të kësaj direktive me ligjin nr. 48/2014 dhe jo me KPC-në.

15. Neni 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, i Kushtetutës përcakton se Gjkata vendos për pajtueshmërinë e ligjit dhe të akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës parashikojnë se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, pasi botohet në Fletoren Zyrtare, bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe ka fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

16. Gjkata vëren se për shkak të angazhimit të Shqipërisë në procesin e integritetit evropian, ligji nr. 48/2014 është përafruar pjesërisht me direktivën nr. 2011/7/BE. Megjithatë, kjo direktivë është pjesë e së drejtës së BE-së (*acquis communautaire*) dhe në kushtet kur Republika e Shqipërisë nuk është shtet anëtar i saj, ky akt nuk është pjesë e rendit juridik të brendshëm. Ashtu siç prapëson edhe subjekti i interesuar, Shoqata Shqiptare e Bankave, pjesë e rendit juridik është ligji nr. 48/2014, që ka përafruar pjesërisht direktivën në fjalë.

17. Po kështu, është e vërtetë se në disa raste Gjkata në vendimmarrjen e saj i është referuar së drejtës komunitare (*shih vendimet nr. 56, datë 27.7.2016; nr. 48, datë 15.11.2013; nr. 3, datë 5.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*), por nuk ka vendosur për pajtueshmërinë e akteve normative të rendit juridik të brendshëm me një akt të BE-së. Referimi në aktet e së drejtës komunitare i ka shërbyer analizës kushtetuese krahasimore në drejtim të zhvillimit të koncepteve kushtetuese nën dritën e standardeve ndërkombëtare.

18. Për sa më lart, Gjkata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese për papajtueshmërinë e dispozitës ligjore të kundërshtuar me direktivën 2011/7/BE qëndron jashtë juridiksionit kushtetues, pasi kjo direktivë nuk është pjesë e rendit juridik shqiptar në kushtet kur Republika e

Shqipërisë nuk i ka përmbyllur ende procedurat për integrimin në BE. Për rrjedhojë, Gjykata, duke respektuar kufijtë e juridiksionit të saj, të përcaktuara në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës dhe të drejtën e gjyqtarëve për të kërkuar kontrollin kushtetues të ligjeve sipas nenit 145, pika 2, të saj, do të vlerësojë përputhshmërinë e dispozitës ligjore të kundërshtuar me Kushtetutën, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, MSA-në dhe KEDNJ-në, të ratifikuara rregullisht me ligj.

19. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës edhe për pretendimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor, me argumentin se çështja përbën *res judicata*, pasi Gjykata, me vendimin nr. 39, datë 16.10.2007, ka marrë në shqyrtim dhe ka vendosur kushtetutshmërinë e togfjalëshit “*si dhe aktet e dhënies së kredive bankare*” të nenit 510, shkronja “d”, të KPC-së.

20. Po kështu edhe gjykata referuese i referohet vendimit nr. 39, datë 16.10.2007, të Gjykatës, duke parashtruar se pavarësisht se debitori ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv në fazën e ekzekutimit, ky mjet është jo efektiv. Sipas saj, dispozita ligjore e kundërshtuar cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor në kuptimin substancial në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës, pasi nuk i siguron konsumatorit mbrojtjen e duhur ndaj ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve, duke e rënduar atë me barrën e kamatës ligjore të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare”. Ndërhyrja në të drejtën e pronës nuk shoqërohet me garancitë procedurale të nevojshme për individin, të përcaktuara nga nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Legjislacioni i brendshëm nuk ka mjet efektiv për mbrojtjen e debitorit, pasi procesi gjyqësor i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit zhvillohet në dhomë këshillimi pa praninë e palës, në mungesë të mbrojtjes dhe pa kontradiktoritet mbi ligjin ose provat.

21. Gjykata vëren se parimi i gjësë së gjykuar kufizon juridiksionin e saj për shqyrtimin e një çështjeje. Ky kufizim parashikohet nga neni 31/a, pika 2, shkronja “dh” i ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kërkesa nuk kalon për shqyrtim në seancë plenare kur kërkimet e paraqitura janë objekt i një vendimi të mëparshëm të saj.

22. Në çështjen konkrete, gjykata referuese ka kërkuar kontrollin kushtetues të nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të KPC-së, me argumentin se përllogaritja e kamatave ligjore të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” në një gjykim pa pjesëmarrjen e debitorit konsumator dhe pa kontradiktoritet cenon nenin 42 të Kushtetutës. Ndërsa në vendimin nr. 39, datë 16.10.2007 Gjykata ka vendosur se një dispozitë tjetër e KPC-së, konkretisht neni 510, shkronja “d”, që parashikon cilësimin e akteve për dhënien e kredive bankare si tituj ekzekutivë, nuk cenon nenin 42 të Kushtetutës, edhe pse gjykimi për lëshimin e titujve ekzekutivë bëhet pa kontradiktoritet dhe pa pjesëmarrjen e debitorit.

23. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se çështja konkrete, ndonëse në dukje është e ngjashme, në thelb është paraqitur me objekt dhe shkak të ndryshëm kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e procesit të rregullt ligjor nga dispozita e kundërshtuar nuk përbën gjë të gjykuar dhe çështja hyn në juridiksionin kushtetues.

B. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

24. Nenet 145, pika 2 dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës parashikojnë se Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, kur gjyqtarët gjatë gjykimit çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën. Në këtë rast ata nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës.

25. Gjykata vëren se objekti në procedurën e kontrollit incidental përfshin edhe të drejtën e gjyqtarëve për të kërkuar pajtueshmërinë e ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare, çështje e cila në vetvete bën pjesë në juridiksionin kushtetues në bazë të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe nenit 5 të Kushtetutës, sipas të cilit Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, që do të thotë se verifikimi i pajtueshmërisë së ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare përbën çështje kushtetuese.

26. Gjykata, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, i cili është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, ka zhvilluar disa kriterë kumulative për legjitimitimin e gjykatës referuese për

inicimin e kontrollit incidental të normës ligjore për pajtueshmëri me Kushtetutën. Sipas tyre, gjykata referuese duhet që gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet pranë saj: i. të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii. të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese – pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; iii. të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iv. të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 8, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim, gjykata referuese ka pezulluar gjykimin dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatë, duke parashtruar se parashikimi i shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të KPC-së lidhur me llogaritjen e kamatave ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare”, bie në kundërshtim me nenet 5, 41, 42, 116, 121, 122 dhe 123 të Kushtetutës, nenet 6, 70 dhe 76 të MSA-së, nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të saj, pasi ka cenuar të drejtat e konsumatorit, të drejtën e pronës private, në aspektin e parimit të proporcionalitetit, të drejtën e procesit të rregullt ligjor, si dhe lirinë kontraktore.

28. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë kundërshtuar legjitimitimin e gjykatës referuese me argumentin se nuk plotësohen dy prej kriterëve kumulative, që kanë të bëjnë me lidhjen e drejtpërdrejtë të dispozitës ligjore të kundërshtuar me çështjen kushtetuese dhe me mundësitë e gjykatës referuese për të zgjidhur gjykimin e saj me norma të tjera, konkretisht duke zbatuar drejtpërdrejt marrëveshjen ndërkombëtare, në përputhje me nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës. Ato janë shprehur se gjykata referuese nuk mund të iniciojë një gjykim kushtetues abstrakt për kontrollin e një norme ligjore që nuk zgjidh themelin e çështjes, në kushtet kur procesi gjyqësor i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit ka natyrë formale dhe jo përfundimtare. Në shtesë të këtyre argumenteve për legjitimitimin, Këshilli i Ministrave ka prapësuar se vendimmarrja e Gjykatës duhet të shtrihet vetëm për shprehjen “*në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*” dhe se gjykata referuese ka pezulluar gjykimin pa marrë mendimin e bankës kërkuese për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, e cila preket drejtpërdrejt nga procedura e kontrollit incidental në aspektin e vonësës përtej afateve të arsyeshme të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

29. Edhe subjekti tjetër i interesuar, Shoqata Shqiptare e Bankave, ka prapësuar se gjykata referuese nuk plotëson asnjë kriter për legjitimitimin e saj, pasi nuk ka identifikuar ligjin e zbatueshëm, nuk ka parashtruar arsye serioze antikushtetutshmërie, nuk ka argumentuar përse gjykimi prej saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues, nuk ka hetuar në mënyrë shteruese mundësinë e zgjidhjes së çështjes nëpërmjet zbatimit të dispozitave të tjera ligjore, si dhe nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar këtë dispozitë në përputhje me Kushtetutën. Për më tepër, qëndrimi i gjykatës referuese është në kundërshtim me praktikën e ndjekur nga vetë ajo në çështje të ngjashme.

30. Për sa u takon kriterëve për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, Gjykata thekson se gjykata referuese duhet të arsyetojë efektin e drejtpërdrejtë që ka dispozita e kundërshtuar si antikushtetuese për gjykimin pranë saj, duke e identifikuar si të zbatueshme për rastin konkret. Kjo nënkupton se kriteri për identifikimin e dispozitave ligjore, që gjykata referuese çmon se bien ndesh me Kushtetutën, nuk konsiderohet i plotësuar thjesht me paraqitjen e tyre formalisht në kërkesë, pasi ato duhet të jenë identifikuar dhe individualizuar se zgjidhin mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Po kështu, siç ka vënë në dukje jurisprudenca kushtetuese, dispozita e kundërshtuar duhet të ketë lidhje me gjykimin në gjykatën referuese në atë masë që ai nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata kushtetutshmëria e dispozitës ligjore (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 30, datë 25.5.2015; nr. 26, datë 22.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Duke iu referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se BKT-ja, bazuar në nenin 510, paragrafi “d”, nenin 511 e në vijim të KPC-së dhe në ligjin nr. 48/2014, i është drejtuar gjykatës referuese me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, si dhe për

parashikimin e kamatave ligjore për titullin ekzekutiv të kontratës së kredisë bankare konsumatore të datës 20.3.2018, të nënshkruar mes saj dhe një individi kredimarrës. Gjykata referuese, gjatë shqyrtimit të kërtimeve të bankës kredidhënëse, me vendimin e datës 23.2.2022, ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe ka kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të KPC-së.

32. Neni 511, paragrafi i pestë, i KPC-së parashikon se titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit nga gjykata të urdhrit të ekzekutimit, i cili përmban: a) gjeneralitetet e debitorit dhe kreditorit; b) origjinën e detyrimit; c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit; d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

33. Gjykata referuese ka argumentuar se në bazë të nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të KPC-së, ajo është e detyruar të llogarisë kamatat ligjore të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” sipas legjislacionit në fuqi për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare, pra sipas ligjit nr. 48/2014, i cili në përmbajtje e përjashton zbatimin e tij për konsumatorët.

34. Në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të saj, gjykata referuese ka kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të KPC-së, ndërsa në pjesën arsyetuese ka nënvizuar shprehjen *“gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”*. Për pasojë, siç prapëson me të drejtë subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave, objekti dhe shkaqet e kërkesës së gjykatës referuese lidhen vetëm me këtë shprehje të shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të KPC-së. Edhe pse *prima facie* dispozita ligjore e kundërshtuar përbën dispozitë referuese të një ligj tjetër, Gjykata çmon se është pikërisht ky përcaktim ligjor baza juridike mbi të cilën gjykata referuese duhet t’i japë përgjigje kërimit për të parashikuar në urdhrin e ekzekutimit edhe kamatat ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” që duhen zbatuar ndaj individit (kredimarrës) debitor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se plotësohen kriteret e legjitimitetit të gjykatës referuese që kanë të bëjnë me identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe të lidhjes së drejtpërdrejtë të tij me gjykimin që po zhvillon ajo gjykatë.

35. Gjykata çmon se nuk qëndrojnë argumentet e subjekteve të interesuara që lidhen me natyrën formale të gjykimit që zhvillohet për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për sa kohë vendimi i pezullimit dhe dërgimi i çështjes në Gjykatë është marrë prej gjykatës referuese brenda një gjykimi në proces e sipër. Neni 145, pika 2, i Kushtetutës i lidhur me nenin 68, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, nuk bëjnë përjashtim për llojin e gjykimit, por kërkojnë që gjyqtari të veprojë brenda tij, me kushtin që në atë gjykim të zbatohet ligji që dërgohet për kontroll kushtetues në Gjykatë. Gjithashtu, legjitimiteti kushtetues i gjykatës referuese nuk varet dhe nuk pengohet nga marrja e mendimit paraprak të palës ndërgjyqëse për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes për kontroll kushtetues. Vonesa eventuale që pëson pala ndërgjyqëse në ekzekutimin e titullit ekzekutiv, për shkak të kohëzgjatjes së procedurës së kontrollit incidental, ka lidhje me gjykimin që po zhvillon gjykata referuese, për të cilin Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi i ofrojnë individit mjete dhe garanci specifike (administrative dhe gjyqësore), autonome nga gjykimi kushtetues.

36. Në lidhje me kriterin për parashtrimin e arsyeve të rëndësishme të antikushtetutshmërisë, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se Gjykata në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashatrohen argumente bindëse për t’i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 27.1.2017; nr. 52, datë 26.7.2016; nr. 5, datë 5.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në thelbin e kërkesës së saj gjykata referuese ka argumentuar se dispozita e kundërshtuar cenon të drejtat e konsumatorit të garantuara nga marrëveshja ndërkombëtare, të drejtën

kushtetuese të pronës private, në aspektet e parimit të proporcionalitetit dhe të procesit të rregullt ligjor, si dhe lirinë kontraktore, të garantuara nga nenet 5, 41, 42, 116, 121, 122 dhe 123 të Kushtetutës. Parashikimi nga gjykata i kamatës ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare, vendos për palën debitore/konsumatorin - individ një barrë të paarsyeshme ligjore dhe ekonomike, duke i sjellë një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të tij.

38. Gjykata vëren se gjykata referuese, në ndryshim nga sa prapëson subjekti i interesuar Shoqata Shqiptare e Bankave, ka parashtruar në kërkesën e saj arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar në lidhje me normat dhe parimet përkatëse të Kushtetutës, të cilat janë shkelur, sipas vlerësimit të saj. Po kështu, Gjykata vlerëson se nuk pengon plotësimin e këtij kriteri legjitimimi as argumenti tjetër i subjektit të interesuar se gjykata referuese ka mbajtur qëndrim të kundërt në raste të tjera të mëparshme, kur është kërkuar lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për aktet e dhënies së kredisë bankare konsumatore. Verifikimi i praktikave të mëparshme të gjyqtarit që ka dërguar çështjen në Gjykatë, sipas nenit 145 të Kushtetutës, nuk përbën objekt kontrolli kushtetues. Për më tepër, Kushtetuta dhe ligji nuk vendosin kufizime për procedurën e kontrollit incidental bazuar në vendimmarrjet e mëparshme të gjykatës referuese.

39. Për sa i takon kriterit që lidhet me përpjekjet e gjykatës për ta interpretuar dispozitën ligjore të kundërshtuar në përputhje me Kushtetutën, Gjykata ka theksuar se vetëm në rast se gjyqtari referues vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si të zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, duke shqyrtuar përmbajtjen e kërkesës, vlerëson se gjykata referuese ka dhënë arsye të mjaftueshme për plotësimin edhe të këtij kriteri legjitimimi.

40. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Gjykata çmon se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitimit, në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000, ndaj, në vijim, do të kontrollojë pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me MSA-në të shprehjes “në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare” në nenin 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të KPC-së, për pjesën që kjo dispozitë ligjore përcakton detyrimin e gjykatave për llogaritjen e kamatave ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare konsumatore”.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e së drejtës së pronës private të lidhur me lirinë ekonomike

41. Gjykata referuese ka pretenduar se dispozita e kundërshtuar cenon të drejtën e pronës private të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi kamata ligjore për pagesa të vonuara të kredisë së marrë për konsum tejkalon kufizimet e përcaktuara në KEDNJ dhe nuk respekton parimin e proporcionalitetit sipas nenit 17 të Kushtetutës. Sipas gjykatës referuese, neni 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të KPC-së urdhëron që kamata ligjore e titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” të përllogaritet sipas nenit 5 të ligjit nr. 48/2014. Ajo ka parashtruar se dispozita ligjore e kundërshtuar nuk e mbron konsumatorin debitor, i cili është në pozicion të dobët në kontratat standarde, pasi sjell humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të tij.

42. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se pretendimi i gjykatës referuese është i pabazuar, pasi dispozita e kundërshtuar mbron interesin e rëndësishëm publik të lidhur me stabilitetin e sistemit bankar dhe ndërgjegjësimin e konsumatorit për rëndësinë e shlyerjes në kohë të shumave të kredisë. Parashikimi që ka bërë ligjvënësi është i përligjur dhe i justifikuar në këndvështrimin e konceptit kushtetues “interes publik”. Gjykata referuese ka paragjykuar barrën e detyrimit që i ngarkohet konsumatorit pa kryer një vlerësim real ekonomik të detyrimit në rastin konkret. Ajo ka injoruar faktin që ligji nr. 48/2014 shprehimisht e ka përjashtuar individin konsumator nga zbatimi i tij. Lidhur me lirinë ekonomike, subjektet e

interesuara kanë prapësuar se gjykata referuese nuk ka parashtruar shkaqe reale kushtetuese që sjellin antikushtetutshmërinë e normës së kundërshtuar.

43. Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, ndonëse është organ kushtetues me përgjegjësinë kushtetuese për zbatimin e pavarur të politikave monetare, nuk ka mbajtur qëndrim për kërkesën dhe nuk ka paraqitur ndonjë argument kushtetues në ndihmë të gjykimit. Ky subjekt është mjaftuar me dërgimin e informacionit se me vendimin nr. 47, datë 1.9.2021, Këshilli Mbikëqyrës ka shtuar në nenin 7, shkronja “p”, të rregullores parashikimin me përmbajtjen: *“Penalitetet dhe kamatëvonesat e parashikuara në shkronjën “p”, pika 2 e këtij neni, të cilat paguben nga kredimarrësi, nuk tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30% të shumës së detyrimit kontraktor (kësti/këste të papaguara të kredisë)”*. Sipas tij, ky përcaktim ka fuqi juridike deri në momentin që gjykata nxjerr urdhrin e ekzekutimit për titullin ekzekutiv, ku aplikohen kamatëvonesat sipas nenit 511 të KPC-së.

44. Subjekti tjetër i interesuar, Shoqata Shqiptare e Bankave, ka prapësuar se dispozita ligjore e kundërshtuar nuk cenon parimin e proporcionalitetit. Gjykata referuese ka keqinterpretuar rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pasi penaliteti u referohet kësteve të papaguara të kredisë. Kur lëshohet urdhri i ekzekutimit, kontrata e lidhur ndërmjet palëve konsiderohet e zgjidhur dhe banka kërkon kthimin e të gjithë kredisë së papaguar, duke përfshirë këstet e pamaturuara, sipas planit të pagesës, interesat dhe penalitetet e akumuluar, përfshirë edhe vlerën 30% të përlllogaritur mbi këstet e papaguara deri në ato momente. Gjithashtu, nuk qëndron as pretendimi për cenimin e lirisë ekonomike, pasi liria kontraktore lidhet me cilësinë e kredisë bankare si titull ekzekutiv dhe jo me nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit. Në procedurën e nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit nuk përcaktohen kushte kontraktore të tjera përveç atyre që janë pranuar nga palët në kontratën e kredisë bankare. Sipas tij, shpallja antikushtetuese e shkronjës “d” të nenit 511 të KPC-së cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike të subjekteve bankare, të cilat i realizojnë interesat e tyre ekonomike përmes kredidhënies bankare.

45. Neni 11 i Kushtetutës parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike, nënkupton, kryesisht, të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve, por forma më e lartë e saj nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave. Po kështu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, lirinë fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit, lirinë e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror, lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Kushtetuta, në nenin 41, pika 1, ka parashikuar se e drejta e pronës private është e garantuar. Në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se koncepti kushtetues i pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, përfshin edhe detyrimet financiare, pasi pagesa e një sasive të caktuar të hollash është një shumë që merret nga pasuria e individit (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Në çështjen konkrete dhe duke iu referuar standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se nuk qëndron argumenti i gjykatës referuese se neni 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, i KPC-së cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike për shkak se debitorin kredimarrës konsumator e vendos në pozicion të dobët në kontratat standarde të kredisë bankare, pasi kjo dispozitë nuk aplikohet për lidhjen e kontratave, por për lëshimin e titujve ekzekutivë. Për këtë arsye, Gjykata do ta

vlerësojë të drejtën e pronës, duke mbajtur në konsideratë se për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese zbatohet edhe parimi themelor i funksionimit të ekonomisë së tregut dhe lirisë ekonomike, i parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës.

48. Në vijim, Gjykata eidenton se dispozita ligjore e kundërshtuar urdhëron përlllogaritjen e kamatës ligjore gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare”, pra të një kontrate të lidhur rregullisht midis palëve. Kjo do të thotë se në procesin e përlllogaritjes kamata ligjore ekuivalentohet në vlerë konkrete monetare, e cila do të merret në përfundim të ekzekutimit të detyrueshëm nga pasuria e kredimarrësit, ndaj Gjykata vlerëson se kamata ligjore përbën pronë private, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës dhe se dispozita e kundërshtuar ndërhyr duke e kufizuar këtë të drejtë kushtetuese.

49. Gjykata ka vënë në dukje se në një shtet demokratik individit duhet t’i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. Me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t’u nënshtrohet kufizimeve. Këto kufizime duhen bërë sipas disa kritereve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës, të cilat kanë të bëjnë me interesin publik, ndërhyrjen vetëm me ligj dhe proporcionalitetin (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Analiza e këtyre kritereve merr rëndësi të veçantë kur analizohen ndërhyrjet në të drejtën e pronës, pasi garancitë e nenit 17 të Kushtetutës ritheksohen në nenin 41 të saj.

50. Gjykata ka pohuar se në rastin e kufizimeve të së drejtës së pronës, identifikimi i interesit publik përbën faktor përcaktues, pasi sipas nenit 41, pika 3, të Kushtetutës ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike. Theksimi për herë të dytë i interesit publik në tekstin e kësaj dispozite, krahas atij të nenit 17 të Kushtetutës, me fushë zbatimi për të gjitha të drejtat dhe liritë themelore që mund të kufizohen, është tregues i rëndësisë së veçantë që kushtetutëbërësi i ka dhënë të drejtës së pronës (*shih vendimin nr. 15, datë 22.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Po kështu, Gjykata është shprehur se sistemi bankar zë vend të rëndësishëm në strukturat ekonomike të një vendi. Ai është një ndër aktorët kryesorë të ekonomisë së tregut, stabiliteti i të cilit është i lidhur drejtpërdrejt me stabilitetin makroekonomik të vendit. Dhënia e garancive ligjore për kthimin e sigurt të kredive bankare i shërben konsolidimit të sistemit bankar, si dhe ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e depozitave financiare të qytetarëve ose subjekteve të tjera (*shih vendimin nr. 39, datë 16.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata vëren se ligjvënësi nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në KPC, me ligjin nr. 114/2016, pjesë e të cilit është dispozita e kundërshtuar, ka synuar stabilitetin e sistemit bankar dhe ndërgjegjësimin e konsumatorit për respektimin e kushteve të përcaktuara në kontratë, me qëllim mbrojtjen e interesit publik. Për rrjedhojë, ajo vlerëson se kufizimi nga dispozita e kundërshtuar përlligjet nga ekzistenca e interesit publik.

53. Për sa i takon kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*” i të drejtave kushtetuese, Gjykata ka pohuar se qëllimi i këtij kriteri është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe, për këtë shkak, vetëm organi më i lartë ligjvënës duhet të jetë kompetent. Shprehja “*vetëm me ligj*” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në çmim të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera. Konteksti në të cilin është përdorur togfjalëshi “*vetëm me ligj*” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta. Rregullimi i parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret, që në këtë rast është Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 20, datë 11.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, gjithashtu, se kur kontrollohet kushtetutshmëria e ndërhyrjeve në të drejtat e njeriut, vlerësimi i kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*”

analizohet si në aspektin formal, në kuptimin nëse ndërhyrja parashikohet nga ligji i miratuar nga Kuvendi, ashtu edhe në aspektin substancial, në kuptimin se sa ligji ofron garancitë e mjaftueshme për ndërhyrjen (*shih vendimin nr. 30, datë 5.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se parimi i sigurisë juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*shih vendimet nr. 24, datë 4.5.2021; nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Formulimet e normave ligjore nuk duhet ta bëjnë të paqartë dhe të pamundur përcaktimin e kuptimit të tyre. Thënë ndryshe, është e nevojshme gjetja e ekuilibrit të duhur, si rrjedhojë e të cilit grupi i individëve që iu adresohet norma ligjore të mos përfshihet në gjendje pasigurie, ndërsa zbatuesit e normës ligjore të ndjekin praktika uniforme në raste të ngjashme (*shih vendimin nr. 24, datë 4.5.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë parimin themelor të shtetit të së drejtës, në këndvështrim të sigurisë juridike, thekson se ligji që kufizon të drejtat kushtetuese duhet të përmbushë kërkesat e cilësisë: ai duhet të jetë i aksesueshëm për të interesuarin (në kuptim të marrjes dijeni) dhe i parashikueshëm për efektet e tij. Po kështu, ligji duhet të jetë mjaftueshmërisht i qartë, me qëllim që t'u japë qytetarëve një tregues të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese të tyre. Me fjalë të tjera, kur Gjykata kontrollon aktet e pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit.

57. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se në pamje të parë aspekti formal i kriterit “kufizimi vetëm me ligj” duket se është përmbushur, pasi dispozita e kundërshtuar është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 114/2016, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim. Nga analiza e mëtejshme e nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të KPC-së vihet re se formulimi i shprehjes “*gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*”, nuk lejon mënyrë tjetër interpretimi përveçse parashikimin e kamatave ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” sipas rregullave të nenit 5 të ligjit nr. 48/2014. Ky i fundit përcakton mënyrën e llogaritjes së kamatëvonesës, duke e zbatuar atë për të gjitha detyrimet ose pagesat, si për ato që rrjedhin nga kontratat me konsumatorë, ashtu edhe për ato që rrjedhin nga veprimet juridike tregtare. Ky konkluzion përforcohet duke iu referuar edhe *travaux préparatoires* të miratimit të dispozitës ligjore. Kështu, referuar procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, kur janë diskutuar ndryshimet e KPC-së të propozuara nga Këshilli i Ministrave dhe të depozituara në Kuvend në datën 9.6.2016, konstatohet se përmbajtja e nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të këtij kodi është riformuluar në mbledhjen e datës 24.10.2016, duke pasur për qëllim që kamatat ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” të parashikohen nga gjykata në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 48/2014.

58. Gjykata vëren se vetë neni 2 i ligjit nr. 48/2014 përjashton nga fusha e zbatimit të tij detyrimet ose pagesat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët. Mirëpo pavarësisht përmbajtjes së nenit 2 të ligjit nr. 48/2014, në rastin e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare konsumatore”, gjykata e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në nenin 511 të KPC-së, është e detyruar të përlllogarisë kamatat tregtare të përcaktuara nga neni 5 i ligjit nr. 48/2014. Kjo do të thotë se formulimi i dispozitës së kundërshtuar detyron gjykatat që në procedurën e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit për tituj ekzekutivë “kontrata bankare të

kredisë konsumatore”, që i hap rrugën ekzekutimit të detyrueshëm të tyre, të përllogarisin kamatat ligjore sipas ligjit nr. 48/2014. Pra, dispozita duket se bën të zbatueshme të njëjtat rregulla ligjore për kamatat me ato për titujt ekzekutivë “kredi bankare” për qëllime të veprimtarisë tregtare, ndonëse këto dy kategori kredimarrësish janë të ndryshme. Gjithashtu, formulimi i dispozitës së kundërshtuar ia delegon pa përjashtim përllogaritjen e kamatave ligjore për titujt ekzekutivë “kredi konsumatore” dhe “kredi tregtare” rregullave të ligjit nr. 48/2014, ndonëse ky i fundit shprehimisht përjashton nga fusha e zbatimit të tij detyrimet ose pagesat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët. Në këtë mënyrë, dispozita e kundërshtuar nuk përmbush kriterin e parashikueshmërisë së kërkuar nga parimi i sigurisë juridike në rastin e ndërhyrjeve që bën ligjvënësi në të drejtat kushtetuese, përfshirë të drejtën e pronës.

59. Duke i përmbledhur vlerësimet e mësipërme për aspektin substancial, Gjykata çmon se neni 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, i KPC-së nuk është formuluar në mënyrë cilësore, siç kërkon ky aspekt i kriterit kushtetues “kufizimi vendoset vetëm me ligj” të nenit 17 të Kushtetutës. Duke mbajtur në konsideratë se mosplotësimi edhe vetëm i një kriteri e bën ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën, analiza e kriterit të proporcionalitetit është e panevojshme.

60. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se është i bazuar pretendimi i gjykatës referuese se dispozita e kundërshtuar cenon të drejtën kushtetuese të pronës, në vështrim të mënyrës si kjo dispozitë përcakton detyrimin e përllogaritjes së kamatës ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare konsumatore”.

61. Në kushtet kur fusha e zbatimit të dispozitës së kundërshtuar shtrihet mbi të gjitha rastet e akteve të dhënies së kredive bankare, pra tejkalon ato të kredive konsumatore, atëherë shfuqizimi i saj do të passillte vakum ligjor për marrëdhëniet juridike, që nuk janë objekt i gjykimit kushtetues. Për pasojë, Gjykata çmon të deklarojë se zbatimi i nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të KPC-së, në shprehjen “*që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*”, nuk është në përputhje me Kushtetutën në rastet e akteve për dhënie kredie bankare konsumatore, me qëllim që kjo dispozitë të përjashtohet nga rendi juridik vetëm për këto lloj aktesh.

62. Në vijim, Gjykata thekson se vlerësimi për papajtueshmërinë e dispozitës ligjore me nenin 17 të Kushtetutës, për shkak të mosrespektimit të kriterit “vetëm me ligj”, nuk nënkupton se në rastin e ekzekutimit të detyrueshëm të akteve të dhënies së kredive bankare konsumatore nuk duhet të parashikohen kamata ligjore, pasi siç u arsyetua më lart në këtë vendim, parashikimi i tyre, edhe në rastin kur kredimarrës janë konsumatorët, i përgjigjet interesit publik (*shih paragrafin 52 të këtij vendimi*). Arsyetimi i Gjykatës për papajtueshmërinë kushtetuese të dispozitës ligjore përbën detyrim për ligjvënësin, i cili, brenda hapësirës së tij të vlerësimit, duhet të rishikojë kufizimin e vendosur me nenin 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të KPC-së, me qëllim që masat e kamatave ligjore për titujt ekzekutivë “akt i dhënies së kredisë bankare” të jenë të parashikueshme, të qarta dhe të konsiderojnë ndryshimin që ekziston midis kredimarrësit konsumator dhe atij që ushtron veprimtari tregtare. Në këtë kontekst, Gjykata ripohon se stabiliteti i sistemit bankar dhe ndërgjegjësimi i kredimarrësve për respektimin e kushteve të përcaktuara në kontratat e kredive bankare përbën interes publik për qëndrueshmërinë e ekonomisë së vendit. Për këtë arsye, është e rëndësishme që Kuvendi të marrë masat e duhura dhe në kohën e duhur për të rregulluar në përputhje me parimet dhe standardet kushtetuese mënyrën e përllogaritjes së kamatave ligjore në rastin e titujve ekzekutivë “kontrata bankare të kredive konsumatore”. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson që Kuvendit t’i caktohet afati 6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit për të plotësuar ligjin sipas arsyetimit të këtij vendimi.

63. Nga ana tjetër, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë nevojën për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, çmon se vendimi i saj duhet të hyjë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare, duke vënë në dukje se arsyetimi i këtij vendimi është i detyrueshëm për zbatim në procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë “akte të dhënies së kredive bankare konsumatore”.

C.2. Për cenimin e procesit të rregullt ligjor

64. Gjykata referuese ka parashtruar se dispozita ligjore e kundërshtuar nuk i siguron individit masën e duhur të mbrojtjes ndaj ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve dhe ndërhyrja që ajo sjell në të drejtën e pronës nuk shoqërohet me garancitë procedurale të nevojshme për individin, të përcaktuara nga nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Legjislacioni i brendshëm nuk ka mjet efektiv për mbrojtjen e debitorit, pasi procesi gjyqësor i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit zhvillohet në dhomë këshillimi pa praninë e palës, në mungesë të mbrojtjes dhe pa kontradiktoritet mbi ligjin apo provat.

65. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se ky pretendim përbën *res judicata*, pasi Gjykata është shprehur për këtë kërkim me vendimin nr. 39, datë 16.10.2007. Ndërsa, subjekti tjetër i interesuar, Shoqata Shqiptare e Bankave, ka prapësuar se referuar edhe vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës, në thelbin e vet dispozita e kundërshtuar nuk e cenon të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor. Objekti i kërimit, në çdo rast, do të jetë një detyrim konkret i përlogaritur sipas ligjit nr. 48/2014, i cili nuk përbën një shumë fikse, por një formulë që është e aplikueshme rast pas rasti.

66. Gjykata vëren se në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Po kështu, neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sanksionon se çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin e qetë të pasurisë duhet të jetë e ligjshme.

67. E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe garantimin e respektimit të parimit të kontradiktoritetit, për të cilin Gjykata ka evidentuar rëndësinë që secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

68. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata ripohon se procedura e urdhrit të ekzekutimit për aktet e dhënies së kredisë bankare në vetvete nuk cenon standardet e procesit të rregullt ligjor, pasi debitori ka të drejtën e mjeteve mbrojtëse të fazës së ekzekutimit të parashikuara në KPC. Kufizimi me ligj i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe në veçanti të elementit të kontradiktoritetit në gjykim, bazohet në interesin publik dhe është i përligjur në mënyrë të arsyeshme (*shih vendimin nr. 39, datë 16.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

69. Gjykata, në ndryshim nga vendimmarrja e mëparshme e shprehur në vendimin nr. 39, datë 16.10.2007, vëren se në rastin konkret kundërshtohet fakti që gjykata referuese në procedurën e lëshimit të urdhrit, krahas elementeve formale të ekzistencës së titullit ekzekutiv, duhet të kryejë edhe një veprim tjetër – atë të përlogaritjes së shumës të kamatave ligjore. Ky veprim kryhet përmes identifikimit të ligjit të zbatueshëm në fuqi dhe nxjerrjes së shumave konkrete, që nuk është gjë tjetër veçse një veprim përlogaritës për përcaktimin e së drejtës/detyrimit kryesor (objekt i ekzekutimit të detyrueshëm), që në rastet e akteve të dhënies së kredive bankare ka vetitë e duhura “detyrim i sigurt, i kërkueshëm dhe i përcaktueshëm”. Në vlerësimin e Gjykatës, kamata ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare”, duke qenë e lidhur me detyrimin kryesor, nëse ligji i zbatueshëm është i plotë, i saktë dhe i qartë nuk ndryshon thelbin e gjykimit të urdhrit të ekzekutimit, si një proces për verifikimin e elementeve formale të titullit të ekzekutimit. Me fjalë të tjera, dispozita ligjore e kundërshtuar ndonëse ndërhyr tek e drejta kushtetuese e procesit të rregullt, ndërhyrja është në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës.

70. Për sa më lart, Gjykata çmon se në thelbin e vet e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, nuk cenohet, ndaj ky pretendim i gjykatës referuese është i pabazuar.

C.3. Për cenimin e mbrojtjes së konsumatorit sipas MSA-së

71. Gjykata referuese ka parashtruar se kamata ligjore e titullit ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” vendos një barrë të paarsyeshme ligjore dhe ekonomike ndaj konsumatorit individ, që do të thotë se kufizon mbrojtjen e tij në kundërshtim me detyrimet e marra përsipër nga shteti shqiptar në zbatim të neneve 6 dhe 70 të MSA-së. Sipas saj, dispozita ligjore bie ndesh

me nenin 76 të MSA-së dhe për këtë shkak cenon edhe parimin e hierarkisë së normave, në kuptim të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës.

72. Subjekti i interesuar, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve, ndonëse i ngritur si institucion pikërisht në zbatim të angazhimeve që rrjedhin nga MSA-ja, nuk ka mbajtur qëndrim për kërkesën. Ky subjekt i është përgjigjur me shkrim thirrjes së Gjykatës për pjesëmarrje në gjykim, ku nuk parashtrohen argumente kushtetuese. Ai është mjaftuar me deklarin se çështja lidhet me një dispozitë ligjore që nuk është pjesë e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe, për rrjedhojë, nuk është pjesë e përgjegjësi të tij.

73. Gjykata ka theksuar se respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Kushtetuta në nenet 5, 116 dhe 122 të saj parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i radhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve (*shih vendimin nr. 65, datë 10.12.1999, të Gjykatës Kushtetuese*).

74. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata evidenton se MSA-ja është një marrëveshje kuadër për marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë dhe BE-së dhe shteteve anëtare të saj nga ana tjetër. Kjo marrëveshje është ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 dhe ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009, pas ratifikimit të saj nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Ajo synon mbështetjen e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, dhënien e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik dhe social në Shqipëri, dhe në rajon, përafrimin e legjislacionit shqiptar me të drejtën komunitare dhe mbështetjen e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin drejt një ekonomie tregu funksionale. Në këtë mënyrë, MSA-ja është një marrëveshje, e cila ka krijuar një proces asociimi të palëve në funksion të stabilizimit dhe përgatitjes së Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin eventual në BE.

75. Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, kjo marrëveshje parashikon se gjatë fazës së parë përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësore të *acquis* të Tregut të Brendshëm, ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme, duke i kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes së konsumatorit (*neni 70*). Sipas MSA-së, palët do të bashkëpunojnë për përafrimin e standardeve për mbrojtjen e konsumatorëve në Shqipëri me standardet komunitare. Mbrojtja e efektshme e konsumatorit është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut, mbrojtje e cila varet nga zhvillimi i një infrastrukture administrative për të siguruar mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë. Për këtë qëllim, edhe në kuadër të interesave të tyre të përbashkëta, palët do të inkurajojnë dhe garantojnë: një politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën komunitare; harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri me atë ekzistues në Komunitet; mbrojtjen efikase ligjore për konsumatorët, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit dhe ruajtjen e standardeve të duhura të sigurisë; monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe garantimin e aksesit të drejtësisë në rast mosmarrëveshjesh (*neni 76*).

76. Gjykata vëren se me anë të këtyre dispozitave të MSA-së palët kanë marrë përsipër të bashkëpunojnë që Republika e Shqipërisë të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe t'i përafrojë ato me standardet komunitare, për të garantuar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut. Ky angazhim, sipas neneve 70 dhe 76 të MSA-së, është parashikuar të materializohet në mënyrë graduale dhe sipas programit të rënë dakord midis palëve, që përfshin masa politike, ligjore, administrative dhe gjyqësore. Në ndryshim me sa parashtron gjykata referuese, në rastin konkret dispozita ligjore e kundërshtuar nuk rezulton të jetë miratuar për të

zbehur mbrojtjen aktive dhe efikase ligjore të konsumatorëve dhe as në kuadër të harmonizimit të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri me atë ekzistues në BE. Një masë e tillë, e nxjerrë në kuadër të MSA-së, është përafrimi i pjesshëm i ligjit nr. 48/2014 me të drejtën komunitare, ligj i cili jo vetëm nuk është kundërshtuar nga gjykata referuese, por, për më tepër, nuk zbatohet për konsumatorët (neni 2, shkronja “b”).

77. Duke mbajtur në konsideratë natyrën e angazhimeve që Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër me anë të MSA-së, të cilat janë graduale në kohë, nuk rezulton ndonjë detyrim specifik në këtë marrëveshje ndërkombëtare që të jetë shkelur nga miratimi i dispozitës ligjore të kundërshtuar.

78. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese se dispozita e kundërshtuar bie ndesh me detyrimet e Republikës së Shqipërisë që rrjedhin nga MSA-ja për mbrojtjen e konsumatorëve, është i pabazuar. Po kështu, Gjykata çmon se është i pabazuar edhe pretendimi për cenimin e parimit të hierarkisë së normave, në kuptim të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, për sa kohë që si shkak i cenimit të tij është paraqitur mosrespektimi i detyrimeve të MSA-së.

79. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e gjykatës referuese është e bazuar sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi dhe se zbatimi i nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d” të KPC-së, në shprehjen “*që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*”, në rastet e akteve për dhënie kredie bankare konsumatore, nuk është në përputhje me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Të deklarojë se zbatimi i nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile, në shprehjen “*që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*”, nuk është në përputhje me Kushtetutën në rastet e akteve për dhënie kredie bankare konsumatore.

2. Të detyrojë Kuvendin e Shqipërisë të plotësojë ligjin sipas arsyetimit të këtij vendimi brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e vendimit.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 2.11.2022.

Shpallur më 30.11.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska